

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Numri i prokurimit: **622-26-3081-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Mbushja dhe servisimi i aparateve për zjarrëfikës për objektet e shëndetësisë primare.(projekt 3 vjeçar)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardani, Rr. 28 Nentori, LI-2, Lok 129

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044148645

(Numri Telefonit)

Latif Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com

(Adresa elektronike)

05.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- | | |
|---------------------------------|--------------|
| - Njoftimi për kontratë | – 07.05.2026 |
| - Hapja e ofertave | – 09.06.2026 |
| - Njoftimi mbi vendimin e AK-se | – 21.07.2026 |
| - Kërkesa për rishqyrtim | - 26.07.2026 |
| - Vendimi i AK-se – refuzimi | - 27.07.2026 |

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

- | |
|-------------------------|
| - Me datën – 09.06.2026 |
|-------------------------|

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues “Pro Global” shpk – Prishtine, me datën 27.07.2025, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se dhe ne afatin paraparë me LPP, e ka kundërshtuar vendimin e AK – Komuna Prizren, propozimin për dhënie te kontratës gjegjesisht ofertën e kompanis se rekomanduar për dhënie te kontratës me prova konkrete dhe baze ligjore por qe AK, po te njejten dite nxjerr vendmim dhe refuzon kerkesen tone pa e trajtuar asnjerin nga pretendimet tona ankimroe ashtu siç kerkohet me nenin 108/A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 61 Tenderët me çmime jonormalisht të ulëta .

Neni 69 Aftësia teknike dhe profesionale e operatorëve ekonomikë

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese

Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mos marreveshjeve.

Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022

Neni 97 Shkeljet e renda.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Neve si OE pjesemarres ne këtë procedure te prokurimit me daten 21.07.2026, kemi pranuar njoftimin mbi vendmin e AK-se ku kunderligjshem eshte propozuar për dhënie te kontratës kompania e pa pergjegjeshme dhe se kjo procedure e prokurimit pergjate gjithe procesit te saj është karakterizuar me

parregullesi serioze si ne vlerësim te ofertave po ashtu edhe ne rekomandim te OE te rekomanduar për kontrate

Ne si OE te demtuar ne kuptim te nenit 108/A te LPP-se dhe brenda afatit te parapare me ligj kemi paraqitur kundër argumentet tona te bazuara me ligj dhe me gjendje faktike dhe kemi kerkuar anulim te vendmit apo propozimit për dhënie dhe kthimine lendes ne ri vlerësim por qe AK, ka lejuar qe te procedohet tutje pavaresisht shkeljeve bazike ligjore, prandaj ne pajtim me nenin 109 te LPP-se, paraqesim këtë ankese kunder vendimeve te AK-se.

Pretendimi ankimor 1

Pas shqyrtimt dhe analizimit te dokumentacionit të operatorit ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës rezulton se i njejti ka dorezuar oferte te pa pergjegjeshme si ne: **aspektin administrativ, aspektin teknik dhe atë financiar.**

Pra për këtë procedure prokurimit sipas dosjes se tenderit dhe procesverbalit te hapjes se ofertave afati i fundit për dorëzimin perkateisht hapja e ofertave është realizuar me daten 09.06.2026,

Ndërsa Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë në oferte, ka paraqitur Autorizimin nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent me Nr. 87/23 të datës 26.06.2023 **me validitet deri me 26.06.2026.**

Dosja e tenderit eshte Kornize kontrate 3 vjeqare, deri ne vitin 2029.

Kjo licencë kishte afat vlefshmërie prej 3 vitesh dhe e njejta ka skaduar më datë 26.06.2026, si rrjedhojë e kesaje, autorizimet e reja nga AME me nr. 186/102, nr. 187/102 dhe nr. 190/102, janë lëshuar më datë 07.07.2026.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës permban datën 21.07.2026.

Pra nga data 26.06.2026, koha kur ka skaduar licenca e vjetër, deri më datë 07.07.2026, koha kur janë lëshuar autorizimet e reja, ekziston shkëputje kohore prej 11 ditësh gjatë së cilës Operatori ekonomik nuk ka poseduar asnjë autorizim apo licencë të vlefshme nga AME për ushtrimin e veprimtarisë.

Licencat e reja të datës 07.07.2026, nuk përmbajnë asnjë efekt retroaktiv, rrjedhimisht, ato nuk përbëjnë vazhdimësi të licencës së vjetër, por paraqesin dokument te ri - të drejta të reja juridike të fituara tek më datën 07.07.2026.

Neni 72 i LPP-së, lejon Autoritetin Kontraktues të kërkojë vetëm sqarime ose plotësime të dokumenteve ekzistuese, por ndalon rreptësisht pranimin e dokumenteve me përmbajtje të re materiale të krijuara pas afatit të dorëzimit të ofertave dhe se **licenca e re e datës 07.07.2026 nuk ka ekzistuar fare më datë 09.06.2026 apo në momentin e hapjes së ofertave.**

Pranimi i një dokumenti të krijuar rreth një muaj pas hapjes publike të ofertave përbën ndryshim material të kualifikimit të OE-së pas afatit të ofertimit, gjë që është në kundërshtim të plotë me nenin 72 dhe praktiken e vendimmarrjes ne OSHP.

Pra objekti i kontratës është "Mbushja dhe servisimi i aparateve për zjarrefikës..." dhe ka kohëzgjatje 3-vjeçare, posedimi i autorizimit/licencës valide nga AME është kërkesë konkrete kualifikuese sipas Kërkesës 4, Pika 7.1 & 7.2 të Dosjes së Tenderit ku shprehimisht është kërkuar.

Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Ministria perkatese për ushtrimin e veprimtarise për servisim te aparateve për zjarrefikese

Deshmia

Licence valide nga organi perkates për servisimin dhe rimbushjen e aparateve zjarrefikese, te jete me validitet – matjen e pikave te rrufepritesit dhe pertokesimit, te jete me validitet – matjen e shtypjes hidranteve, te jete me validitet.

Pra AK-ja, e ka kualifikuar si të përgjegjshme ofertën e OE-së që në momentin e vlerësimit mbështetej në licenca të skaduara, ka shkelur parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë në trajtim ndaj të gjithë ofertuesve të tjerë, të cilët kanë qenë të obliguar të përmbushin kërkesat e tenderit brenda afatit ligjor

Prova 1 – Licenca e OE date 26.06.2023

	Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo Qeveria –Vlada-Government	
Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/ Emergency Management Agency		
Nr. <u>87 / 23</u> Datë. <u>26/06 / 2023</u>		
Agjencia e Menaxhimit Emergjent, bazuar në Ligjin nr. 04/1-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri me nr. 04/L-012 si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 25/2012 Lidhur me Kushtet e Marrjes me Punët e Avancimit të Mbrojtjes nga Zjarri lëshon:		
Autorizim		
Autorizohet ALBKOS SAFETY SH.P.K më seli në Fushë Kosovë me nr. të biznesit 811440908 për zhvillimin e punëve për avancimin e mbrojtjes nga zjarri si ne vijim:		
Kontrollimi dhe servisimi i pajisjeve-aparateve për shuarjen e zjarreve fillestare		
Ky Autorizim vlen tri (3) vite nga data e nënshkrimit me mundësi vazhdimi.		
Arsyetim		
ALBKOS SAFETY SH.P.K më seli në Fushë Kosovë ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent me nr.0002602/23 për dhënien e autorizimit për zhvillimin e punëve për avancimin e mbrojtjes nga zjarri për pikën: kontrollimi dhe servisimi pajisjeve-aparateve për shuarjen e zjarreve fillestare.		
Pasi shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe dokumentacionit të bashkangjitur në bazë të njoftimit të shpallur me nr;17/2016 të datës; 26.08.2016 komisioni vlerësues në bazë të procesverbalit ka vlerësuar se kompania ALBKOS SAFETY SH.P.K më seli në Fushë Kosovë i plotëson kushtet themelore për ushtrimin e kësaj veprimtarie.		
Shefki Abdullahu Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm i AME-së 		



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs
Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog Upravljanja/
Emergency Management Agency

Nr. 186 102
Datë: 07/07/2026

Agjencia e Menaxhimit Emergjent, bazuar në Ligjin nr. 04/1-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri 08/L-261. Udhëzimin Administrativ nr. 25/2012 Lidhur me Kushtet e Marrjes me Punët e Avancimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe procesverbalin e komisionit të datës 07.07.2026 lëshon këtë:

Autorizim

Autorizohet **ALBKOS SAFETY SH.P.K** më seli në Fushë Kosovë me nr. të biznesit 811440908 për zhvillimin e punëve për avancimin e mbrojtjes nga zjarri si ne vijim:

Punët e testimit të rezistencës së tokëzimit në instalimet rrufepritëse

Ky Autorizim vlen tri (3) vite nga data e nënshkrimit me mundësi vazhdimi.

Arsyetim

ALBKOS SAFETY SH.P.K më seli në Fushë Kosovë ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent me nr.0005184/26 për dhënien e autorizimit për zhvillimin e punëve për avancimin e mbrojtjes nga zjarri për pikën: punët e testimit të rezistencës së tokëzimit në instalimet rrufepritëse.

Pasi shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe dokumentacionit të bashkangjitur në bazë të njoftimit të shpallur me nr;17/2016 të datës; 26.08.2016 komisioni vlerësues në bazë të procesverbalit ka vlerësuar se kompania **ALBKOS SAFETY SH.P.K** më seli në Fushë Kosovë i plotëson kushtet themelore për ushtrimin e kësaj veprimtarie.



Shëfkë Abdullahu
Ushtrues detyrë i Drejtorit Ekzekutiv në AME

Pretendimi ankimor 2

Ne Dosjen e tenderit - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika **9.1 & 9.2** kërkesa 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar qartë:

Kërkesa 1. Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 52.500,00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kapacitetit teknik dhe profesionale të referencave të natyrës së kontratës.

Pavaresisht kërkeses se sipër pershkruar, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke e konsideruar si të përgjegjshme ofertën e Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë, përkundër faktit se ky operator nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar për referenca profesionale.

Pra në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për realizimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë minimale prej 52,500.00 € ku edhe pas kërkesave për sqarime nga

Autoriteti Kontraktues, apo sqarimeve te ofruara operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë referenca në vlerën e kërkuar dhe nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit pasi qe, referencat e prezantuara si ne vijim:

- **Komuna e Gjakovës në vlerë prej 6,400.00 €, me përshkrimin "Furnizim me mjete dhe pajisje kundër zjarrit" dhe per,**
- **Korporaten Energjetike te Kosoves ne vlere 76 988.65 euro per pershkrimin FURNIZIM SISTEMI AUTOMATIK PËR SHUARJEN E ZJARRIT ME AEROSOL,**
NUK mund të konsiderohen si referenca te natyrës së ngjashme me shërbimin objekt i këtij aktiviteti të prokurimit, pasi **objekti i kontratës ne DT është Mbushja dhe servisimi i aparateve zjarrfikëse (100% sherbime),** ndërsa furnizimi me pajisje paraqet natyrë tjetër të aktivitetit dhe nuk dëshmon përvojë në kryerjen e shërbimeve të kërkuara ne dosjen e tenderit.

Per me teper edhe pas sqarimeve shtese të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, ndaj te njejt OE, I njejt nuk ka arritur të dëshmojë referenca të mjaftueshme në vlerën minimale prej 52,500.00 €, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Pranimi i këtyre referencave si përvojë relevante përbën vlerësim të njeanshem dhe favorizues ndaj kompanise dhe shkel ne teresi parimet bazike te prokurimit publik

Fakti që Dosja e Tenderit ka te përcaktuar objektin e kontrates qe ka te beje me mbushje dhe servisimi i aparateve zjarrfikëse do të thotë se përvoja e kërkuar duhet të lidhet me kryerjen e shërbimeve të njëjta ose të ngjashme, si:

- servisimin e aparateve zjarrfikëse;
- kontrollimin teknik;
- mbushjen apo rimbushjen apo edhe
- mirëmbajtjen e aparateve kundër zjarrit.

Pra Operatori Ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës nuk ka arritur të dëshmojë se përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit lidhur me përvojën profesionale dhe referencat e ngjashme.

Referenca me përshkrimin "Furnizimi me mjete dhe pajisje kundër zjarrit" nuk dëshmon kurrfare ngjashmerie me realizimin e sherbimeve të mirëmbajtjes, kontrollit teknik, servisimit apo mbushjes së aparateve zjarrfikëse dhe si e tillë **NUK** mund të konsiderohet referencë e natyrës së ngjashme.

Përkundër mundësisë së dhënë për sqarime shtese OE nuk ka arritur të korrigjojë apo të dëshmojë ekzistencën e referencave të kërkuara, prandaj Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar duke e konsideruar ofertën si të përgjegjshme pasi qe kontrata e natyres se sherbimeve nuk ka kurrfare lidhje me kontratat e furnizimeve, kontrata apo referenca te cilat komisioni vleresues i ofertave dhe zyrtari pergjegjes i prokurimit i kane trajtuar si te mireqene ku me keto veprime kane konsumuar shkelje ligjore nga neni 7, 59 dhe 69 te LPP-se

OE i propozuar per kontraten ne Letren per Sqarime shtese ka sqaru referencat me poshte, te cilat nuk jane te te natyres se ngjashme dhe nuk e arrine vleren e kerkuar

Prova 3 – Sqarimet shtese nga OE i propozuar per kontrate

Komuna e Prishtines	39.644,00
KRUP	3.740,50
Komuna e Gjakovës	6.400,00
Spitali i Pejës	1.969,00
Komuna e Obiliqit	2.301,40
KEK	76.988,65

➤ Nuk eshte Reference e ngjashme

➤ Nuk eshte Reference e ngjashme

Ndersa qe referencat me përshkrimin:

"Furnizimi me mjete dhe pajisje kundër zjarrit" (Komuna e Gjakoves) apo "FURNIZIM SISTEMI AUTOMATIK PËR SHUARJEN E ZJARRIT ME AEROSOL" (Kororata Energjetike e Kosoves) ,



NUK mund të konsiderohet referencë e ngjashme, sepse, furnizimi është shitje/dorëzim i mallrave dhe jo shërbim !

Prova 4– Kontrata per Furnizim me mallra nga Komuna e Gjakoves

DATE/A:	12.12.2024
REFERENC-Ë:	Zyrtar
PËR/ZA/TO:	"Albkos Safety SH.P.K" rruga e Pejës nr. 26, Fushë Kosovë z. Emin Mirena - përfaqësues
CC:	Arkiva
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Komuna e Gjakovës
NGA/OD/FROM:	Menaxher i kontratës; Kaqun Lima - Udhëheqës i Operativës Brigada e Zjarrfikëseve, Komuna e Gjakovës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	REFERENCE



Të nderuar,

Kompania "Albkos Safety SH.P.K" rruga e Pejës nr. 26, Fushë Kosovë, me përfaqësues z. Emin Mirena ka realizuar kontratën me titullin ;

"Furnizimi me mjete dhe pajisje kundër zjarrit" për Brigaden e Zjarrfikëseve në Komunën e Gjakoves.

Numri i kontratës: 632-24-4689-1-2-1/C963

Vlera e kontratës: 6,400.00 €

Datë: 29.07.2024

PROCESVERBAL I KOMISIONIMIT PAS INSTALIMIT

SISTEMI AUTOMATIK PËR SHUARJEN E ZJARRIT ME AEROSOL

RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK neni 10.

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vleres se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	69
--	--	----

Pretendimi ankimor 3.

Nga analiza e ofertës financiare të Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë rezulton se ekzistojnë mospërputhje të dukshme në strukturën e çmimeve të ofruara për shërbimet e mbushjes dhe servisimit të aparateve kundër zjarrit dhe si te tilla nga OE do duhej te trajtoheshin me çmime manipulative marre parasysh faktin se objekti i këtij aktiviteti të prokurimit përfshinë Mbushjen dhe servisimin e aparateve kundër zjarrit, duke përfshirë mbushjen me pluhur dhe CO₂, servisimin teknik dhe ndërrimin e pjesëve sipas nevojës, Kornize kontrate 3 vjeqare.

Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar çmime që nuk paraqesin proporcionalitet me llojin, kapacitetin dhe kompleksitetin e aparateve dhe atë si me poshte:

- Për aparatin zjarrfikës P6 kg (**pluhur 6kg**), është ofruar çmimi **P6 = 32.00 €**;
- Për aparatin zjarrfikës P9 kg (**pluhur 9kg**), është ofruar çmimi **P9 = 34.00 €**,
- Për aparatin zjarrfikës P25 kg (**pluhur 25kg**), është ofruar çmimi **P25 = 32.00 €**,
- Për aparatin zjarrfikës P50 kg (**pluhur 50kg**), është ofruar çmimi **P50 = 32.00 €**,

Pra, për aparatin zjarrfikës P50kg (**pluhur 50kg**), është ofruar cmim sikurse per aparatin zjarrfikes P6 kg (**pluhur 6kg**), eshte jonormalisht i ulet, përkatësisht çmim manipulativ, përkundër faktit se aparati P50kg ka kapacitet dhe kosto të mirëmbajtjes dukshëm më të lartë, apo 8 here me te larte se sa P6.

Pra për aparatin zjarrfikës P9kg (**pluhur 9kg**) , është ofruar çmimi më i larte se sa per P50kg (**pluhur 50kg**), përkundër faktit se aparati P50 kg ka kapacitet dhe kosto të mirëmbajtjes dukshëm më të lartë 6 here me te larte se sa P50kg.

Cmimi per pluhur sillet rrethe 2.0 euro/kg, (perfshi blerjen, transportin, doganen, tvsh)

Prova 8 – Fatura e blerjes se pluhurit

Kostoja per pluhur per aparatin zjarrfikes P6kg eshte $6 \times 2.00 = 12.00$ euro.

Kostoja per pluhur per aparatin zjarrfikes P50kg eshte $50 \times 2.00 = 100.00$ euro.

Kostoja e servisimit te aparatave zjarrfikes sillet rrethe 6.00 euro/cope.

Kjo nenkupton se Mbushja me pluhur dhe servisim per P6kg duhet te jete rrethe 18.00 euro

Kjo nenkupton se Mbushja me pluhur dhe servisim per P6kg duhet te jete rrethe 106.00 euro

Ne rast se duhet ndrru dhe pjese, kostoja rritet dhe me shume.

Cmimi per pluhur sillet rrethe 1.5 euro/kg, kostoja per pluhur per aparatn zjarrfikes P6kg eshte 9.00 euro. Kostoja e servisimit te aparatave zjarrfikes sillet rrethe 6.00 euro/cope.

Kjo nenkupton se Mbushja me pluhur dhe servisim per P6kg duhet te jete rrethe 15.00 euro

Pra ky fakt tregon kjarte për manipulim me oferte financiare tentative për abuzim me parane publike dhe ne si kompani nuk do te kursehemi pavaresisht koston dhe këto tentativa për abuzim me procedure prokurimi do ti raportojmë ne prokurorine perkatese.

Njejte eshte vepruar dhe ne raport me Aparat P25 kg, ku struktura e çmimit krijon dyshime objektive mbi realitetin ekonomik të ofertës dhe mbi mënyrën e kalkulimit të kostove për realizimin e kontratës.

Duke marrë parasysh se **bëhet fjalë për kontratë kornizë 3-vjeçare dhe se sasia e shërbimeve mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vlerën totale të kontratës**, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që të analizojë në mënyrë të hollësishme arsyeshmërinë e këtyre çmimeve dhe të kërkojë justifikim të plotë për kalkulimin e tyre dhe doemos te aplikoj **dispozitat e nenit 61 te LPP-se dhe dispozitat e rregullores për çmime jo noramlisht te ulëta**.

Neve si OE jemi te bindur se operatori ekonomik mund të ketë pasur informacione lidhur me sasitë reale të aparateve për secilin pozicion, duke i mundësuar atij të vendosë çmime jo proporcionale dhe potencialisht të favorshme në pozicione të caktuara, duke bere shkelje te **neni 61 i LPP-së** – Tenderët me çmime jonormalisht të ulëta dhe se tani me neve jemi ne proces e sipër te deponimit te kerkeses për qajse gjegjesisht te njoftimit te Agjencionit për Informim dhe Privates me qellim te argumentimit dhe konfirmimit te perfshirjes se grupit te caktuar ne veprime penale.

Prova 4 – Cmimet e OE te propozuar per kontrate

PARAMASAT PËR APARATE KUNDËR ZJARRIT PËR 3						
VITE (2026–2028)						
Nr.	APARATI KUNDËR ZJARRIT	TIPI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	SHUMA
1	Aparati	P	6Kg	138	32.00	4,416.00
2	Aparati	P	9Kg	390	34.00	13,260.00
3	Aparati	P	12Kg	108	30.00	3,240.00
4	Aparati	P	25Kg	18	32.00	576.00
5	Aparati	P	50Kg	66	32.00	2,112.00
6	Aparati	Co	5Kg	60	30.00	1,800.00
7	Matja e Pikave Rrufepritisit	/	/	780	4.00	3,120.00
8	Matja e Pikave të Hidranteve	/	/	210	20.00	4,200.00
9	Shenja e preventivës	/	/	240	0.50	120.00

Te gjitha këto prova dhe dëshmi te sipër prezantuara tregojme dhe konfirmojne qe AK – Komuna Prizren, komisioni i vlerësimit te ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit me paramendim po tentojne te lidhin kontrate kundërligjore me kompani te pa pergjegjeshme duke shkelur secilen dispozite

ligjore, duke shkelur deklaratat nen betim dhe kodin e etike profesionale prandaj Operatori Ekonomik ankues “Proglobal Shpk, kerkon qe OSHP dhe zyrtaret pergjegjes te autorizojne ekspert shqyrtues profesional, me integritet, te pa aneshem i ciolet bazuar ne dispozitat e nenit 113 dhe 114 te LPP-se i trajtojne te gjitha pretendimet ankimore te anashkaluara nga AK – Komuna Prizren ne ate menyre qe paneli shqyrtues te nxjerr ketë:

V E N D I M

- I. Aprovohet**, ne tere si e bazuar ankesa e OE “Progobal SHPK si e bazuar.
- II. Anulohet, si i kunderligjeshem** njoftimi AK-se, propozimi per kontrate i datës 21.07.2026 dhe lenda te kthehet ne Ri-vleresim
- III. Te lejohet**, kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Kompania jone si rezultat i shkeljeve ligjore dhe mos prezantimit te deshmive ne formen siq jane ne ketë procedure te prokurimit është demtuar dhe bazuar ne provat dhe deshmite materiale te neve lenden mund ta procedojme edhe ne organe tjera nese nuk ndermerren veprime ligjore perkatese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme dhe te cilat ne tere si do te kalkulohen dhe te kompensohen.
--

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshem/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
- h) ***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.